



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore
Nr. 01-111/01-9073
Gjakovë

Datë: 15.04.2021

Në bazë të nenit 67 dhe 68, të Ligjit numër 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenit 5 pika c të Ligjit numër 03/L-068 mbi Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, nenit 37 paragrafi 2 i Ligjit numër 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Udhëzimit Administrativ numër 10/2018 Për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, si dhe nenit 2 paragrafi 2 të Statutit të Komunës, Komuna e Gjakovës shpall:

RISHPALLJE E KONKURSIT
Për plotësimin e vendeve të lira të punës

✓ **Titulli i vendit të punës:** Mësimdhënës/e për lëndën e gjuhës gjermane (*gjashtë pozita*)

Nr.	Institucioni	Pozita	Vend i lirë/Zëvendësim
1.	Shkolla "Pjetër Muqaj" në Guskë Shkolla "Ardhmëria" në Ramoc Shkolla "Dy Dëshmorët" në Sheremet	Një (1) mësimdhënës/e për lëndën e gjuhës gjermane (4) orë mësimi në javë Një (1) mësimdhënës/e për lëndën e gjuhës gjermane (4) orë mësimi në javë Një (1) mësimdhënës/e për lëndën e gjuhës gjermane (4) orë mësimi në javë	Vend i lirë Gjithsej 12 orë
2.	Shkolla "Ukshin Miftari" në Skivjan Shkolla "Selman Riza" në Gjakovë	Një (1) mësimdhënës/e për lëndën e gjuhës gjermane (4) orë mësimi në javë Një (1) mësimdhënës/e për lëndën e gjuhës gjermane (12) orë mësimi në javë	Vend i lirë Gjithsej 16 orë
3.	Shkolla "Dëshmorët Lleshi" në Doblibare Shkolla "Pjetër Bogdani" në Demjan 2	Një (1) mësimdhënës/e për lëndën e gjuhës gjermane (4) orë mësimi në javë Një (1) mësimdhënës/e për lëndën e gjuhës gjermane (5) orë mësimi në javë	Vendi i lirë Gjithsej 9 orë
4.	Shkolla "Ali Hasi" në Cërmjan Shkolla "Ahmet Rrustemi" në Bec Shkolla "Dëshmorët e Dushkajës" në Bardhaniq Shkolla "Dëshmorët e Kombit" në Shqiponjë	Një (1) mësimdhënës/e për lëndën e gjuhës gjermane (4) orë mësimi në javë Një (1) mësimdhënës/e për lëndën e gjuhës gjermane (4) orë mësimi në javë Një (1) mësimdhënës/e për lëndën e gjuhës gjermane (4) orë mësimi në javë Një (1) mësimdhënës/e për lëndën e gjuhës gjermane (4) orë mësimi në javë	Vend i lirë Gjithsej 16 orë
5.	Shkolla "Mazllum Këpuska" në Gjakovë Shkolla "Fehmi Agani" në Gjakovë	Një (1) mësimdhënës/e për lëndën e gjuhës gjermane (4) orë mësimi në javë Një (1) mësimdhënës/e për lëndën e gjuhës gjermane (10) orë mësimi në javë	Vend i lirë Gjithsej 14 orë

6.	Shkolla "Emin Duraku" në Gjakovë	Një (1) mësimdhënës/e për lëndën e gjuhës gjermane (12) orë mësimi në javë	Vendi i lirë Gjithsej 12 orë
----	----------------------------------	--	---------------------------------

Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për pranimin e zyrtarëve publikë

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik.

Detyrat dhe përgjegjësitë për Mësimdhënësit

- Të realizoj planprogramin mësimor për vendin e punës , në harmoni me legjislacionin në fuqi, që të rregullojë fushat përkatëse për vendin e tij/saj të punës;
- Të zbatoj detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies;
- Të përgatit me rregull planin mësimor, në përputhje me Kurrikulën Bërthamë;
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe vlerësimit në përputhje me Udhëzimet Kurikulare;
- Të mbajë ditarin personal të vlerësimit të nxënësve;
- Të marrë pjese aktive në organizimet jashtë mësimore me nxënës, si dhe
- Detyrat tjera që janë të përcaktuar me legjislacionin në fuqi.

Kushtet dhe Kualifikimi:

Në bazë të Udhëzimit Administrativ numër 10/2018 për Normativin Mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, për mësimdhënës të gjuhës gjermane kërkohet:

- **Niveli master arsimor – Fakulteti i Edukimit (300ECTS);**
- **Sistemi katërvjeçar;**
- **Bachelor (katërvjeçar 240 ECTS)**

Dokumentet e nevojshme:

- Formulari i aplikimit i plotësuar;
- Rezymeja Personale (CV);
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë) kopje;
- Diplomat e kualifikimit (ose certifikatat), certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë të noterizuara tek noteri dhe jo më të vjetra se gjashtë muaj. Çdo certifikatë e diplomës më e vjetër se gjashtë muaj nga data e diplomimit nuk do të merret parasysh;
- Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kenë të nostrifikuara diplomat nga MASHT;
- Certifikatën nga Gjykata se nuk është nën hetime (originali);
- Dëshmi të përvojës në institucione arsimore **(nëse ka).**

Dokumentet duhet të jenë në kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi).

Afati dhe mënyra e aplikimit:

30 ditë nga dita e publikimit të konkursit mbetet vetëm njoftim, ndërsa konkursi mbetet i hapur 15 ditë, aplikacionet dorëzohen nga data **17.05.2021** deri me **31.05.2021**(16:00).

Paraqitja e kërkesave:

Aplikacionet merren në *Qendrën e Informimit*, kati përdhese në ndërtesën e administratës së Komunës së Gjakovës si dhe mund të shkarkohet nga ueb-faqja zyrtare e Komunës së Gjakovës, dhe i plotësuar dorëzohet personalisht në *Zyrën e Pranimet* apo të dërgohen me postë në këtë adresë: *Komuna e Gjakovës, Rr. "UÇK" nr. 53, 50000 Gjakovë, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, Kati III.*

Rezultatet shpallën në linkun: <https://konkursi.rks-gov.net/> dhe <https://kk.rks-gov.net/gjakove/category/konkurset-njoftimet/>

-Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen.